



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT



KONFERENCA STUDENTORE 2019 UNIKO

Departamenti i Edukimit pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin
"Fan S. Noli" Korçë

në bashkëpunim me:

Departamentin e Histori-Gjeografisë

Departamentin e Gjuhëve të huaja

Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë

Departamentin e Matematikës dhe Fizikës

si dhe

Departamentin e Pedagogjisë të Universitetit Shtetëror të Tetovës

ju fton në Konferencën Studentore:

"GJITHËPËRFSHIRJA NË VEPRIM"

Korçë, 19 korrik 2019

Qëllimi i konferencës

Departamenti i Edukimit ka nxitur dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm trajnimin e stafit mësimdhënës nëpërmjet veprimtarive të rregullta përgjatë vitit akademik si konferenca, takime të përbashkëta dhe tryeza pune, por edhe studentët, të cilët janë përfshirë rregullisht në këto veprimari. Konferenca do të shërbejë si një leksion i hapur, ku studentët do të kenë mundësi të shkëmbejnë informacionet dhe njohuritë e tyre, të debatojnë dhe të hedhin ide rreth tematikave që lidhen me profesionin e tyre.

Ajo synon nxitjen e studentëve dhe motivimin e tyre drejt orientimit të kërkimit dhe studimit shkencor, në funksion të zgjerimit të dijeve dhe përgatitjes profesionale, duke mbajtur parasysh të mësuarit për një botë me diversitet, duke zbatuar strategji të reja për përmirësimin e këtij diversiteti, si dhe duke nxitur një klimë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.

Një nga objektivat e konferencës është promovimi i bashkëpunimit kërkimor mes pedagogut dhe studentit nëpërmjet përfshirjes së këtij të fundit në kërkime të përbashkëta me pedagogun dhe të drejtuar prej tij. Punimet pjesëmarrëse në konferencë do jenë rezultat i këtij bashkëpunimi.

Vendi qendror i kësaj konference do të jenë studentët, të cilët do të jenë të punësuarit e nesërm që do të përballen me zhvillimet e reja në sektorin e arsimit.

Aplikime

Janë të ftuar të aplikojnë për t'u bërë pjesë e Konferencës Studentore 2019:

- **Studentët e vitit të parë dhe të dytë të nivelit “Master shkencor” dhe “Master Profesional”**
- **Studentët e vitit të tretë të nivelit Bachelor**
- **Gjithashtu ftohen të marrin pjesë dhe ish-studentë, Alumni**

Tema e konferencës:

Konferenca është e strukturuar në një temë bosht, me qëllim kryesor gjithëpërfshirjen në veprim, temë e cila do të fokusohet në disa nëntema më të thjeshta, të cilat nuk do të përjashtojnë asnjë punim origjinal që mund të paraqitet në lidhje me fushën e edukimit.

Nëntemat:

- *Arsimi gjithëpërfshirës*
- *Aspekte të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit*
- *Specifika të mësimdhënies në fusha dhe disiplina të ndryshme*
- *Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie*
- *Kompetencat në kurrikulën e re në arsimin parauniversitar*

si dhe çdo tematikë tjetër që lidhet me natyrën e programeve studimore në fushën e edukimit.

Këto nëntema nuk janë shteruese, por thjesht orientuese. Pjesëmarrësit mund të trajtojnë nëntema të tjera në kuadër të temës kryesore ose nëntemave të propozuara.

Data të rëndësishme:

- **27 qershor 2019** Afati i fundit i regjistrimit të abstrakteve
- **2 korrik 2019** Pranimi përfundimtar i abstrakteve
- **12 korrik 2019** Informim mbi detajet e programit të konferencës
- **19 korrik 2019** Zhvillimi i konferencës
- **2 shtator 2019** Dorëzimi i punimit të plotë

Punimi

Artikulli duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, formati **A4**, me kufij: lart **2.5 cm**; poshtë **2,5 cm**; majtas **2,5 cm**; djathtas **2,5 cm**.

Teksti duhet të jetë e shkruar në Microsoft Word (.doc ose .docx). Font - **Times New Roman**, madhësia **12 pt**;

• Hapësira:

Hapësira mes rreshtave - **1.5**; Ndërmjet paragrafëve një hapësirë rreshti, duhet aplikuar në të gjithë artikullin, duke përfshirë edhe faqen e titullit, abstraktin, trajtimin, referencat, shtojcat, shënimet, tabelat dhe figurat.

• Faqja kryesore:

Ajo duhet të përmbajë titullin e punimit, emrin e autorit dhe mbiemrin, e-mail-n dhe të vazhdojë në rreshtin tjetër me abstraktin.

Ne rekomandojmë që titulli juaj të jetë jo më shumë se **12 fjalë** në gjatësi dhe nuk duhet të përmbajë shkurtesa.

• Abstrakti:

Abstrakti duhet të jetë i kufizuar, rreth **150-200 fjalë**. Ai duhet të përshkruajë shkurtimisht çështjen studimore që do të diskutohet në artikull dhe të japë një përmbledhje koncize të gjetjeve.

Fjalët kyç jo më shumë se **5 fjalë**, *italic*.

Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word (.doc ose .docx).

Abstraktet/punimet do të pranohen nëse i plotësojnë kushtet dhe kërkesat brenda fushave tematike dhe kriteret e përgatitjes së abstraktit dhe punimit të plotë.

Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

Botimi

Të gjithë punimet e pranuar në konferencë do të përmblihen në një botim të veçantë që do të përgatitet pas zhvillimit të konferencës, i pajisur me **ISBN**.

Pjesëmarrësit e konferencës do të pajisen me certifikatën e pjesëmarrjes në konferencë.

Punimet, të cilat do të kalojnë suksesshëm vlerësimin sipas standardeve të njohura të kërkimit shkencor, do të merren në konsideratë për t'u botuar.

Bordi shkencor i konferencës

Prof. dr. Ali Jashari

Prof. as. dr. Irena Nikaj

Prof. as. dr. Pavllo Cicko

Prof. as. dr. Aleksandra Piluri

Prof. as. dr. Jonela Spaho

Prof. as. dr. Lulzim Mehmedi

Prof.as.dr. Elona Çeçe

Dr. Erinda Papa

Dr. Benita Stavre

PhD. Metin Venxha

Dr. Arto Adili

Bordi organizativ

Dr. Alba Kreka

Dr. Albina Pajo

Dr. Alda Cicko

Msc. Arjan Kamburi

Msc. Olger Brame

Msc. Riollza Agolli

Nuk ka tarifë për pjesëmarrjen në konferencë

Informacion shtesë

Për të dërguar abstraktin dhe punimin, për të komunikuar njoftimet për pjesëmarrjen si dhe për çdo informacion të nevojshëm, lutemi të shkruani në **adresën elektronike zyrtare** të konferencës: fefkonferencastudentore@gmail.com

Regjistrimin e abstraktit mund ta kryeni në mënyrë të drejtpërdrejtë në linkun Google form në faqen zyrtare të UNIKO